



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 939/1 Prot.

Tiranë, më 11 / 06 / 2019

V E N D I M

Nr. 69 , Datë 11 / 06 / 2019

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr. 27 Regj., datë 25.03.2019, të T. S, kundër Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” sh.a Shkodër, me pretendimin për diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*¹”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

KONSTATOI:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, T. S shprehet se ka qenë në marrëdhënie pune me Shoqërinë “Trajtimi i Studentëve” sh.a Shkodër, deri me datë 07.01.2019 dhe ka mbajtur pozicionin e magazinierit. Nëpërmjet shkresës me nr.01 prot., datë 07.01.2019 të Administratorit të kësaj Shoqërie, është

¹ Subjekti ankues provon anëtarësinë e tij në forcën politike të subjektit politik, Partia Lëvizja Socialiste Për Integrim (LSI), me kartën e anëtarësisë me nr.18919, lëshuar me datë 24.09.2016.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

njoftuar për zgjidhjen përfundimtare të marrëdhënieve të punës. Referuar përmbjatjes së kësaj shkrese, evidentohet fakti se ankuesi është larguar nga puna me argumentimin se nuk ka pranuar të punojë në pozicionin e rojes, sipas rekomandimit të Administratorit “*për t’i dhënë mundësinë e pasjes së një vendi pune dhe marrjes së një page*”.

Në shkresë citohet se nëpërmjet vendimit nr.75, datë 07.11.2018 të Këshillit Mbikqyrës është vendosur ristrukturimi i Shoqërisë, gjë që ka pasuar me shkurtimin e personelit, si rezultat i uljes së numrit të studentëve të akomoduar, e cila ka shkaktuar uljen e të ardhurave të Shoqërisë, duke sjellë paaftësi paguese dhe detyrimin e uljes së numrit të punonjëve. Nëpërmjet kësaj shkrese pasqyrohet fakti që subjektit ankues i është ofruar pozicioni i punës si roje, pozicion të cilin ai e ka refuzuar.

T. S pretendon se shkak i vërtetë i largimit të tij nga puna janë bindjet e tij politike, si anëtar i LSI, ndërsa punëdhënësi është përkrahës i partisë në pushtet.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e punëdhënësit, për shkakun sipërcituar.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: “*Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim*”.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

³Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.452/1 prot., datë 28.03.2019 i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve sh.a” Shkodër, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

Me shkresën me nr.44 prot., datë 15.04.2019 Shoqëria “Trajtimi i Studentëve” sh.a Shkodër, ka informuar Komisionerin se:

“T. S ka filluar punë pranë institucionit tonë në pozicionin e elektrikistit, me datë 31.03.2015. Më pas, me Vendimin nr.12, datë 03.06.2016 ky punonjës ka kaluar në pozicionin e marangozit. Administratori J. L është emëruar me Vendimin nr.62, datë 21.12.2017, nga Këshilli Mbikqyrës, ndërsa T. S është larguar nga puna një vit pas emërimit të Administratorit (marrëdhëniet financiare i janë ndërprerë me datë 07.03.2019)”.

Shoqëria “Trajtimi i Studentëve” sh.a Shkodër citon se, pretendimi i ankuesit se është larguar për shkak të bindjeve të tij politike nuk qëndron, pasi vetë Administratori nëpërmjet Urdhërit nr.76, datë 02.07.2018 e ka kaluar në pozicionin e magazinierit të Magazinës Industriale, duke e rritur në detyrë dhe duke i rritur edhe pagën; pra ai është promovuar dhe jo diskriminuar. Nga ana tjetër, ky pretendim nuk qëndron pasi, bindje politike të njëjta me T. S kanë edhe punonjës të tjerë që kanë marrë pjesë në komisione zgjedhore së bashku me T. S (z.E. K, znj.B. D, të cilët kanë marrë pjesë në komisionet zgjedhore si përfaqësues të forces politike LSI) dhe vazhdojnë të jenë në punë.

Me Vendimin nr.75, datë 07.11.2018 të Këshillit Mbikqyrës është kërkuar ristrukturimi i Shoqërisë si rrjedhojë e rënies të të ardhurave të Shoqërisë.

Si rezultat i ristrukturimit u shkurtuan disa pozicione pune, ndër të cilat: ekonomisti i shërbimeve, hidrauliku, marangozi, ndihmës/elektrici, ndihmës/kaldaisti, punonjësi i ngarkim/shkarkimit, magazinieri i Magazinës Rikupero, sportelisti.

Aktualisht në strukturën e re të Shoqërisë, Magazina Rikupero dhe Magazina Industriale janë të përfshira në një Magazinë të vetme dhe ka vetëm një pozicion pune si magazinier.

Në kushtet e ristrukturimit të Shoqërisë, në mënyrë që t’u krijohej një vend pune të gjithë personave që do t’u shkurttoheshin pozicionet e punës dhe të mos largoheshin nga puna, atyre iu

është ofruar pozicioni i punës si roje; pozicione pune që deri aktualisht mbuloheshin nga një shoqëri private (Shoqëria “Miri” sh.p.k).

Shoqëria vijon duke cituar se: *“Meqenëse është e pamundur që punonjësja, së cilës i është shkurtuar pozicioni i punës si sporteliste, të punonjë në pozicionin e rojes, për shkak të vështirësive dhe orareve jo fleksibël të vetë pozicionit dhe gjithmonë ky shërbim është mbuluar nga punonjës të gjinisë mashkullore, pamë të arsyeshme që punonjësën së cilës iu shkurtua pozicioni i punës ta sistemojmë brenda Administratës dhe punonjësit e gjinisë mashkullore të cilëve iu shkurtohej vendi i punës të mbulonin shërbimin e rojeve që më parë është mbuluar nga të tretët. Por gjithmonë jemi nisur nga dëshira dhe vullneti i mirë për t’i dhënë mundësinë e një vendi pune dhe të mos largojmë asnjë nga punonjësit.*

Aktualisht, në pozicionin e magazinieres së Shoqërisë është emëruar punonjësja I. Ç, e cila para ndryshimit të strukturës së Shoqërisë mbante pozicionin e sportelistes (i cili u shkurtua).

Theksojmë se i vetmi që nuk ka pranuar pozicionin e rojes është punonjësi T. S, edhe pse fillimisht ai ka pranuar dhe ka rënë dakord për të pranuar këtë pozicion, gjë që faktohet nga firmosja e procesverbalit. Në momentin që ai ka refuzuar pozicionin e punës si roje kemi zbatuar procedurën ligjore duke respektuar afatet ligjore për njoftimin e shkëputjes së marrëdhënieve të punës me të. Po ashtu, nënvizojmë faktin se 4 (katër) nga punonjësit që kanë pranuar pozicionin e rojes, pas shkurtimit të vendit të tyre të punës, janë me arsim të lartë”.

2. Në vijim të procedurës së ndjekur për shqyrtimin e ankesës, si dhe në zbatim të Urdhërit nr.79, datë 24.04.2019 të Komisionerit, me datë 10.05.2019, pranë ambjenteve të Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” sh.a Shkodër u realizua inspektimi i cili kishte si objekt të tij marrjen e informacionit drejtëpërdrejtë nga punëdhënësi si dhe dokumentacionin shkresor përkatës.

Gjatë inspektimit u mor në cilësi prove dokumentacioni i kërkuar⁴ si dhe nga ana e përfaqësuesit të kësaj Shoqërie, J. L, me detyrë Administrator, u theksua fakti që T. S nuk është diskriminuar për asnjë moment për shkak të bindjeve politike të tij. Rezulton e faktuar se ai është promovuar duke u ngritur në detyrë dhe për më tepër, punonjës me bindje politike të njëjta me të tij vijnë të jenë në marrëdhënie pune me Shoqërinë, dokumentacion provues për të cilët është depozituar nëpërmejt shkresës me nr. 44 prot., datë 15.04.2019 të Shoqërisë.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

⁴ Referuar procesverbalit të mbajtur gjatë inspektimit, si dhe akteve shkresore të marra në cilësi prove.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të administruara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me pretendimin e ankuesit për trajtim të padrejtë nga ana e Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” sh.a Shkodër.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“ Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Mbështetur në dokumentacionin dhe provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezulton se:

Subjekti ankues nëpërmjet shkresës me nr.25 prot., datë 31.03.2015 “Vendim emërimi” ka filluar marrëdhëniet e punës me Shoqërinë “Trajtimi i Studentëve” sh.a Shkodër, në detyrën “Elektiçist”.

Më pas, nëpërmjet shkresës me nr.12 prot., datë 03.06.2016 “Vendim emërimi” ka kaluar nga pozicioni i “Elektiçistit” në atë të “Marangozit”.

J. L është emëruar me Vendimin nr.62, datë 21.12.2017, të Këshillit Mbikqyrës në detyrën e Administratorit.

Nëpërmjet shkresës me nr.76 prot., datë 02.07.2018 “Urdhër i brendshëm” i Administratorit, T. S ka kaluar nga pozicioni i “Marangozit” në atë të “Magazinierit” të Magazinës Industriale.

Ndërkaq, me anë të “Njoftimit nr.118 prot., datë 12.12.2018” të Shoqërisë ankuesit i është njoftuar fillimi i procedurës për përfundimin e kontratës së punës.

Në procesverbalin me nr.137 prot., datë 17.12.2018 rezulton të jetë realizuar takimi mes punonjësit T. S dhe Komisionit të Ristrukturimit të Shoqërisë, ku pasqyrohet fakti i propozimit të pozicionit të rojes për ankuesin. Në procesverbalin me nr.147 prot., datë 31.12.2018 rezulton të jetë realizuar takimi mes punonjësit T. S dhe Komisionit të Ristrukturimit të Shoqërisë, ku pasqyrohet fakti i refuzimit të pozicionit të rojes nga ankuesi.

Në vijim, nëpërmjet shkresës me nr.01 prot., datë 07.01.2019 të Administratorit të Shoqërisë T. S është njoftuar për zgjidhjen përfundimtare të marrëdhënies së punës.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se është trajtuar në mënyrë diskriminuese nga punëdhënësi, lidhur me largimin e tij nga puna, Komisioneri gjykon se Shoqëria “Trajtimi i Studentëve” sh.a Shkodër ka barrën e provës⁵ të provojë që largimi i ankuesit nga puna është kryer për arsye të ligjshme dhe të justifikuara.

Në zbatim të Vendimit nr.77, datë 28.12.2018 të Këshillit Mbikqyrës për “Miratimin e Strukturës së Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” sh. a Shkodër për vitin 2019” Administratori i Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” sh. a Shkodër, nëpërmjet shkresës me nr.156 prot., datë 31.12.2018 ka vendosur miratimin e listës emërore të Strukturës së Re të Shoqërisë, për vitin 2019, e cila ka hyrë në fuqi në datën 01.01.2019.

Nga krahasimi i bërë ndërmjet dy strukturave të Shoqërisë, asaj të vitit 2018 dhe strukturës aktuale, të vitit 2019, konstatohet se:

- Numri i përgjithshëm i punonjësve të Shoqërisë nuk ka ndryshuar në total, pasi 22 ishte në strukturën e vitit 2018 dhe 22 është dhe aktualisht në strukturën e vitit 2019.

⁵Kodi i Punës në neni 9 “Ndalimi i diskriminimit, pikat 9 dhe 10 e tij parashikojnë se: “9. Në rastin kur një person pretendon se është cënuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, sipas këtij Kodi, ndiqet procedura e ankimit, e përcaktuar në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.

10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”.

- Evidentohet se në strukturën aktuale të Shoqërisë nuk ekzistojnë më disa nga pozicionet e punës që ishin në strukturën e vitit 2018. Kështu janë suprimuar pozicionet e: ekonomistit të shërbimeve, hidraulikut, marangozit, ndihmës/elektriçistit, ndihmës/kaldaistit, punonjësit të ngarkim/shkarkimit, magazinierit të Magazinës Rikupero, sportelistes.
- Po ashtu, rezulton e provuar nëpërmjet Kontratës “Shërbim me roje private” me nr.52 prot., datë 29.03.2018, të nënshkruar mes Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” sh.a Shkodër dhe Shoqërisë “Miri” sh.p.k (Kontraktuesi) se gjatë vitit 2018, shërbimi i rojeve është realizuar nga kjo e fundit, për afatin kohor 01.04.2018 deri më datë 31.12.2018.
- Bazuar në Kontratën “Shërbim, pastrim territori dhe godinash” me nr.51 prot., datë 29.03.2019, të nënshkruar mes Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” sh.a Shkodër dhe Shoqërisë “Rozafa ‘94” sh.p.k (Kontraktuesi) se gjatë vitit 2018, shërbimi, pastrimi i territorit dhe godinave të jashtme dhe të brendshme, është realizuar nga kjo e fundit, për afatin kohor 01.04.2018 deri më datë 31.12.2018.
- Nëpërmjet shkresave me numra: 163prot., dhe 164 prot., datë 11.12.2018 janë njoftuar dy Shoqëritë kontraktuese sipërcituar, lidhur me përfundimin e afatit ligjor të kontratave respektive, në afatet e parashikuara në dispozitat e kontratës së nënshkruar, me datë 31.12.2018, duke cituar se: *“Bazuar në Vendimin nr.75, datë 07.11.2018 të Këshillit Mbikqyrës për ristrukturimin e Shoqërisë për shkak të paaftësisë paguese, ju njoftojë se nuk do të ketë procedura tenderimi për këto shërbime”.*

Nga këqyrja dhe verifikimi i dokumentacionit rezulton se:

- Punonjësit, të cilëve iu suprimua/reduktua pozicioni i punës si rezultat i ristrukturimit të Shoqërisë, figurojnë të emëruar në pozicionet e punës: “Rojë” dhe “Pastruese” që iu shtuan Shoqërisë si rezultat i mbulimit të shërbimeve të rojeve dhe pastrueseve me punonjës të brendshëm, gjë të cilën në strukturën e vitit 2018, Shoqëria e mbulonte përmes Kontraktuesve.
- Nga këqyrja e tabelës së pagave korresponduese për secilin pozicion pune të suprimuar/reduktuar dhe që në strukturën e vitit 2019 u zëvendësua me pozicionet e “Rojës” dhe “Pastrueses”, rezulton se paga është rritur. Pra, punonjësit që kaluan në këto pozicione pune si “Rojë” apo “Pastruese” financiarisht trajtohen më mirë aktualisht.
- Përrjashtim nga sa më lart, bën vetëm kalimi nga pozicioni i magazinierit të Magazinës Industriale (pozicion të cilin e mbante ankuesi) në atë të “Rojës” me një diferencë prej 2000 lekësh rënie të pagës.
- Rezulton e provuar nga dokumentacioni i depozituar pranë KMD-së (procesverbale takimi, urdhëra emërimi) se të gjithë punonjësit, të cilëve iu është suprimuar/reduktuar pozicioni i punës, kanë pranuar vullnetarisht të kalojnë në pozicionin e “Rojës” dhe të “Pastrueses”, përveç subjektit ankues. Katër nga punonjësit që kanë pranuar pozicionin e “Rojës” rezulton se kanë mbaruar arsimin e lartë:
 - N.D, i cili në strukturën e vitit 2018 mbante pozicionin e “Marangozit”.

- K.P, i cili në strukturën e vitit 2018 mbante pozicionin e “Elektriçisit”.
- R.S, i cili në strukturën e vitit 2018 mbante pozicionin e “Nd/kaldaistit”.
- A.B, i cili në strukturën e vitit 2018 mbante pozicionin e “Magazinierit” të Magazinës Rikupero. Ky punonjës nëpërmjet shkresës së datës 20.02.2019 është dorëhequr vullnetarisht nga puna, për shkak se ka filluar punë në një institucion tjetër.

Të gjithë punonjësit sipërcituar janë emëruar në këtë pozicion pune nëpërmjet Urdhërave të brendshëm të datës 31.12.2018 të Administratorit.

Referuar kronologjisë dhe dinamikës së ngjarjeve, ardhur si pasojë e procesit të riskstrukturimit të Shoqërisë, Komisioneri, konstaton se, pavarësisht dëshirës dhe vullnetit të mirë të Administratorit të Shoqërisë për të krijuar mundësi risistemimi në strukturën aktuale, për të gjithë punonjësit që prekeshin nga ky proces; subjekti ankues i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Shoqërisë.

Në strukturën e vitit 2019 si rezultat i zbatimit të Vendimit nr.75, datë 07.11.2018 të Këshillit Mbikqyrës për ristrukturimin e Shoqërisë, Magazina Industriale dhe Magazina Rikupero do të bashkoheshin në një të vetme: Magazina Industriale + Rikupero dhe për pasojë nga dy pozicione pune që ishin, do të reduktohej një pozicion pune “Magazinier”. Në kushtet kur kriteret për këtë pozicion pune nuk kishin ndryshuar dhe nga dy magazinierë do të mbetej vetëm një, do të duhej që këta dy punonjës të konkurronin ndërmjet tyre dhe jo të emërohej një punonjëse tjetër, duke i përjashtuar të dy nga konkurimi.

Lidhur me argumentimin e Shoqërisë se ofrimi i pozicionit të rojes ankuesit dhe kalimi i punonjësës I.Ç në pozicionin e magazinieres për shkak të shkurtimeve të vendit të saj të punës dhe pamundësisë për t’i ofruar pozicionin e “Rojës” për arsye objektive, është i arsyeshëm; Komisioneri vlerëson se, Shoqëria ka trajtuar në mënyrë të padrejtë subjektin ankues duke e përjashtuar atë nga e drejta e konkurimit me punonjësin tjetër me të cilin ishin në kushte të njëjta për të konkuruar, gjë e cila ka pasqyruar dhe largimin e tij nga puna për shkak të refuzimit të pranimit të pozicionit të rojes.

Nga analiza e sipërpërmendur dhe në referencë të nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se ankuesi është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Shoqërisë.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2⁶, të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me parashikimet ligjore, në kushtet kur mungon krahasuesi.

Bazuar në dokumentacionin që disponon nga hetimi, Komisioneri vlerëson se “*bindjet politike*” janë shkak për të cilin ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Po ashtu, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, në nenin 9⁷ të tij “Ndalimi i diskriminimit”, parashikon “bindjet politike” si shkak për të cilin ky ligj ofron mbrojtje nga diskriminimi.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*”, Komisioneri gjykon se “bindjet politike” konsiderohen si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD, si dhe subjekti ankues ka depozituar prova të cilat faktojnë se e mbart atë.

⁶“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b)barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo forme sjelljeje që nxit diskriminim.”

⁷ “Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët”.

Subjekti ankues provon anëtarësinë në forcën politike të subjektit politik, Partia Lëvizja Socialiste Për Integrim (LSI), me kartën e anëtarësisë me nr.18919, lëshuar me datë 24.09.2016.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar faktin se ankuesi është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” sh.a Shkodër, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁸ dhe trajtimit të padrejtë apo të pafavorshëm të ankuesit.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerëson se pavarësisht dëshirës dhe vullnetit të mirë të Administratorit të Shoqërisë për të krijuar mundësi risistemimi në strukturën aktuale, për të gjithë punonjësit që prekeshin nga ky proces; T. S i është nënshtruar një qendrimi të padrejtë e disfavorizues nga ana e Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” sh.a Shkodër, krahasuar me punonjësen që është emëruar në pozicionin e magazinieres.

Në kontekst të provimit të faktit që ankuesi nuk është diskriminuar për shkak të bindjeve të tij politike, Shoqëria, ka depozituar pranë KMD, në cilësi prove dokumentacion përkatës, me anë të të cilit provon faktin se:

- Ankuesi është promovuar nga Administratori duke u ngritur në detyrë. Nëpërmjet shkresës me nr.76 prot., datë 02.07.2018 “Urdhër i brendshëm” të Administratorit, T. S ka kaluar nga pozicioni i “Marangozit” në atë të “Magazinierit” të Magazinës Industriale.
- Ka dhe punonjës të tjerë të Shoqërisë, që deklarojnë bindjet e tyre politike, si dhe anëtarësinë në subjektin politik “Lëvizja Socialiste për Integrim”, dhe që nuk janë penalizuar për këtë shkak, por vijnë në punë dhe aktualisht. Dokumentacion provues lidhur me këtë fakt, në referim të punonjësve E.K dhe B. Ll është depozituar pranë KMD-së.
- Bazuar në dokumentacionin shkresor depozituar pranë KMD-së⁹, punonjësja I.Ç e cila mban aktualisht pozicionin e magazinieres së Magazinës Industriale + Rikupero, rezulton

⁸ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

⁹ Vërtetim lëshuar nga Kryetari i LSI, Dega Shkodër, me datë 17.10.2018.

se ka të njëjtat bindje politike me subjektin ankues, të dy janë anëtare të forcës politike LSI, gjë që hedh poshtë favorizimin e saj për shkak të bindjeve politike të njëjta me titullarin e Shoqërisë.

Referuar sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht konstatimit të faktit se T. S i është nënshtruar trajtimit të padrejtë e disfavorizues nga ana e Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” sh.a Shkodër, nuk provohet që ky trajtim të ketë ardhur për shkak të bindjeve të tij politike.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 9, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të T. S, nga ana e Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” sh.a Shkodër, për shkak të bindjeve të tij politike.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Punësim
Shkaku: Bindjet politike

